



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 1275/7 Prot.

Tiranë, më 22/04/2017

V E N D I M

Nr.31, Datë 22.04.2017

**PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË KRYER NË
DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT, QARKU FIER “PËR ZBATIMIN
E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË TË AKTIVITETIT TË
INSTITUCIONIT NË VEPRIMTARINË E MONITORIMIT DHE
MBROJTJES SË MJEDISIT DHE VEPRIMTARINË EKONOMIKO-
FINANCIARE ”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, mendimin e Drejtorit Përgjithshëm, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Auditim tematik dhe vlerësues për ligjshmërinë rregullshmërinë e aktivitetit të institucionit, në veprimtarinë e monitorimit dhe mbrojtjes së mjedisit dhe veprimtarinë ekonomiko financiare*”, ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit, Qarku Fier”, për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR

1. Nga auditimi në DRM Fier, për periudhën 2014, 2015 dhe 2016, lidhur me zbatimin e procedurave ligjore, plotësimin e dokumentacionit dhe argumentimin ligjor të Akt Refuzimeve për Leje Mjedisi Tipi C, konstatoam mangësi në plotësimin e dokumentacionit si: ngatërrimet e emërtimeve të adresave të administratorëve/pronarëve të subjekteve, me adresën e vendndodhjes së ushtrimit të veprimtarisë së biznesit; ngatërrim të numrit të pasurive ku ushtrohet aktiviteti, me numrat e zonës kadastrale; parregullsi dhe mosargumentim ligjor të refuzimeve. Kryesisht u konstatoan formulime të kushteve me fjalë të përgjithshme, kërkesa të paplotësuara dhe mungesë të bazës ligjore, shoqëruar me mosndjekje e mosevidentim në vazhdimësi të procedurave dhe afateve që kanë sjellë **vonesa nga 1 muaj deri 28 muaj, në kundërshtim me afatet procedurale maksimale (prej 16 ditë pune ose 24 ditë kalendarike), mosndjekje e mosevidentim në vazhdimësi të refuzimeve të përsëritura** kryesisht me mosplotësim kriteresh të rëndësishme për mjedisin duke u dhënë përparësi kriterëve të urbanistikës, **gjendje kjo** në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL”, trajtuar në tabelën emërtuar “*Tabela e refuzimeve të lejeve tip C afatet e trajtimit, aktkontrollit, shkaqet DRM Fier viti 2014, 2015 dhe 2016*”, bashkëlidhur raportit.

Rekomandim 1: Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), të marrë masa për të rregulluar dhe përshtatur formatin standard të Aktit Refuzimit, ku të përfshihen numri dhe data e aktit, të cilësohet data e refuzimit të mëparshëm, si dhe data e riaplikimit. Kjo do të bëjë më transparente shërbimin, respektimin e afateve, mospengimi dhe nxitja e biznesit në pajisjen me lejet mjedisore Tipi C etj, kërkesa këto të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për Lejet e Mjedisit Kreu IV, pika 9, “Formati standard i aktit Miratim /refuzimit”, shtojca nr. 6.

Është e nevojshme që këto rregullime të normohen e përfshihen në formatin e një udhëzimi apo rregullore, ku të përfshihet përshkrimi i procedurës në rastet e riaplikimit nga refuzimet, duke përcaktuar datat dhe numrin e refuzimeve, duke përshkruar numrin e kushteve të paplotësuara. Një rregullim i tillë do të rrisë transparencën e DRM, nxisë biznesin dhe mbi të gjitha rrisë shkallën e menaxhimit, duke përcaktuar ngarkesën ndërmjet specialisteve sipas praktikave ndarë praktikë fillestare, praktikë në vazhdim e pjesëshe për se dyti, e pjesëshe për së treti etj, pasi volumi i punës sipas praktikave është i diferencuar ndërmjet atyre në proces (të refuzuara) dhe atyre fillestare për herë të parë.

2. DRM Fier, në periudhën 2014, 2015 dhe 2016 ka lejuar vendimmarrjen për leje të tipit C pa miratimin e NJQV-ve, praktikë e konstatuar në **560 raste** (nga **782 raste**) nga të cilat në **203 raste** (nga **425 dërgesa**) për mos kthim përgjigje brenda afatit treditör nga NJQV-të dhe në **357 raste nga mos dërgimi i kërkesës** për mendim në NJQV, në kundërshtim me kreu IV pika 3 dhe me afatet e procedurës sipas pikës 2, pika 4 dhe pika 5 e VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL”, pasqyruar në tabelën emërtuar “*Tabela e Njoftimeve të DRM Fier të Aplikimeve për tërheqje Mendimi (konfirmimi) nga NJQV për lejet Tip C dhe përgjigjet nga NJQV-të*” sipas viteve, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga analizimi i praktikave, kemi arritur në konkluzionin se afati prej treditör për kthim përgjigje nga NJQV, është jo funksional dhe lejimi i vazhdimit të procedurës nga DRM-ja sipas pikës 4 edhe në mungesë të përgjigjes së NJQV, sjell si pasojë përjashtimin e pjesëmarrjes në vendimmarrje të NJQV, megjithëse pasojat mjedisore bien mbi të.

Rekomandim 2: Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) të ndërmarrë hapat e duhur për të nxitur përmirësimet ligjore lidhur me rishikimin e pikës 3, Kreu IV të VKM nr.419, datë 25.06.2014, lidhur me rritjen e afatit nga 3 ditë, në 1 javë pune, si dhe shfuqizimin e pikës 4, Kreu IV të VKM nr. 419, datë 25.06.2014, *me synim rritjen e pjesëmarrjes së NJQV-ve në procesin e licencimit, pasi veprimtaritë me ndikim në mjedis zhvillohen në juridiksionin dhe territorin e tyre.*

B. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje 1: Në DRM Fier për vitin 2014, 2015 dhe vitin 2016 nuk ka një bazë të dhënash dhe një evidencë të grupuar të refuzimeve sipas shkaqeve (kushteve), sipas aktiviteve, zonave rajonale; (kjo nuk është kërkuar nga AKM Tiranë), ekzistenca e databaze do të nxiste rritjen e shkallës së menaxhimit të DRM Fier, sistemin e MKB, jo vetëm të institucionit por sidomos plotësimin e synimit të nxitjes dhe mbështetjes së subjekteve në procesin e pajisjes me leje mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe do rriste transparencën me publikun dhe integritetin e punonjësve në dhënien e shërbimit në shmangie të fenomeneve tolerante apo tunduese në procesin e licencimit.

Rekomandim 1: DRM Fier dhe AKM Tiranë, të marrin masa të normojnë e të rregullojnë vendosjen një baze të dhënash (e munguar për vitin 2014, 2015 dhe vitin 2016) dhe një evidencë të grupuar të refuzimeve sipas shkaqeve (kushteve), aktiviteve dhe të grupuar në zonat rajonale; numrit të refuzimeve për çdo subjekt, zonave të kërcënuara nga ndotja mjedisore etj me synim rritjen e shkallës së menaxhimit të DRM Fier, funksionimin e sistemit të MKB, reduktimin dhe eliminimin e risqeve, nxitjen dhe mbështetjen e subjekteve në procesin e pajisjes me leje mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit. Kjo do të rrisë transparencën me publikun dhe integritetin e punonjësve në dhënien e shërbimit në shmangie të fenomeneve tolerante apo tunduese në procesin e licencimit dhe rritjen e efektivitetit të punës së specialistëve, bazuar në ngarkesën e kohën e diferencuar të trajtimit të praktikave sipas stadit fillestare apo të përsëritura.

Gjetje 2: DRM Fier ka vepruar në tejkalim të kompetencave në aktrefuzimin nr.36 për subjektin M. Xh, ndodhur rruga Fshat Dukas-Patos akti nr.409, datë 17.06.2016, aplikim datë 10.6.14, ku konstatohet mungesa e lejes urbanistike dhe planvendosjes nga Bashkia Patos, aktiviteti grumbullim e shitje hekurishte i cili ushtrohet në sipërfaqe me pemë e bimësi bari ndërsa nga DRM, në kundërshtim me faktet e mësipërme, rekomandohet betonimi i sheshit (Për te shitur hekurishte dhe ku mungon leja urbanistike dhe planvendosja), si dhe nuk është kërkuar nga DRM vendosja dhe respektimi i kriterit distancë nga rrugët apo qendra e banuar për këtë aktivitet. Kjo është në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisore të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente, deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL”, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, trajtuar në tabelën emërtuar “Tabela e refuzimeve të lejeve tip C, afatet e trajtimit, aktkontrollet, shkaqet DRM Fier viti 2015”.

Rekomandim 2: DRM Fier të marrë masa për rishqyrtimin e praktikës: Akt Refuzim/Miratim në aktrefuzimin nr.36 për subjektin M.Xh. ndodhur rruga Fshat Dukas-Patos akti nr.409, datë 17.06.2016, aplikim datë 10.6.14, ku konstatohet mungesa e lejes urbanistike dhe planvendosjes nga Bashkia Patos. DRM Fier të shfuqizojë rekomandimin për betonim, të kërkojë vendosjen e kriterit distancë nga rrugët apo qendra e banuar për këtë aktivitet, si dhe në mosplotësim të kushteve të anulujë lejen e dhënë dhe të njoftojë DRISHMP Fier.

Gjetje 3: Për vitin 2015 nuk ka një urdhër të brendshëm për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit Teknik, megjithëse konstatohet se ky organizëm ka funksionuar prej datën 27.3.2015, dhe ka zhvilluar 63 mbledhje. Kjo praktikë bie në kundërshtim me Urdhrin e AKM nr.38, datë 17.03.2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Komisionit Teknik për Verifikimin dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi Tipi C në Qarqe”.

Konstatuam se të gjitha urdhëret refuzimet janë marrë në fund të periudhave 3 mujore dhe vjetore, gjë që tregon punë jo ritmike, me pasoje shkelje afatesh, shpërndarje e parregullt e ngarkesës në punë të specialistëve dhe menaxhim jo i rregullt i burimeve njerëzore. Pasoja të mos funksionimit të Komisionit janë dhe faktet e lidhura me 9 Akte Refuzimi pa emra dhe pa firma të specialistëve, por vetëm me firmë të ish-Drejtorit, përkatësisht 5 praktika (15,16,35,36,40) akt refuzimi të nënshkruara pa emrin dhe firmën e specialistit si dhe 4 praktika (11,19,50,55) me emrin dhe pa firmën e specialistit.

Gjithashtu, 19 Akt-Kontrollet (nga 65 akt refuzime), janë kryer duke mos përcaktuar kriteret apo rregullshmëri të vendosura më parë, për cilët raste apo subjekte duhen kryer kontrolle dhe apo cilat raste përjashtohen, pra ka munguar një urdhër, udhëzim apo rregull i vendosur për kontrollet në procesin e refuzimit apo miratimit.

Rekomandim 3: DRM Fier, Drejtori të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit sipas përcaktimeve të vendosura në Urdhrin e AKM nr. 38, datë 17.03.2015”Për Krijimin dhe Funksionimin e Komisionit Teknik për Verifikimin dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi Tipi C në Qarqe”.

Të eliminohet praktika e punës me fushata në fund të periudhave tre mujore, duke synuar një programim të kujdesshëm jo vetëm të problematikave por edhe të burimeve njerëzore në dispozicion.

Gjetje 4: Për vitin 2014, regjistri i refuzimeve nuk është mbajtur me standardin e aprovuar nga Ministria e Mjedisit. Në periudhën Prill-Dhjetor 2014 në shqyrtimin e lejeve të mjedisit të tipit C nuk kanë marrë pjesë specialistët e VNM –së dhe shumicën e Akt-Refuzimeve e ka firmosur vetëm z. S. P ish Drejtori i DRM. Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06., Kreu IV, pika 7, ku citohet se “Akti i miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit C, i dërgohet AKM sipas shtojcës 6, bashkëlidhur vendimit”.

Rekomandim 4: DRM Fier të marrë masat e duhura për të kontrolluar plotësimin e regjistrave sipas standardeve të miratuara nga Ministria e Mjedisit, për gjithë periudhën e vitit dhe nga të gjithë specialistët, të cilët duhet të plotësojnë të gjitha kolonat e formatit me emrin e subjektit, datën e aplikimit, datën e shqyrtimit, specialistin që trajton dosjen dhe duke shënuar në se aplikimi është refuzuar ose jo.

Gjetje 5: Për vitet 2014, 2015 dhe 2016 Drejtori i DRM Fier në asnjë rast nuk ka përgatitur grafik për shqyrtimin e lejeve mjedisore, procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve për shqyrtimin e lejeve kanë mangësi në konceptim dhe formulim, pasi nuk sqarojnë diskutimet, situatat dhe zhvillimin e tyre. Komisionet nuk kanë paraqitur para Drejtorit të DRM Fier informacion të plotë në përputhje me kërkesat e ligjit në kundërshtim me ligjin nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe VKM nr .419 datë 25.06.2014 dhe me pikën nr. 5 të urdhrin nr.109 datë 06.10.2015, “Për zbardhjen e akt miratimeve dhe akt refuzimeve”, të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Rekomandim 5: Drejtori i DRM Fier të marrë masa për dokumentimin dhe përshkrimin e plotë të fakteve të shqyrtuara në procesverbalet e mbajtura në mbledhjet e komisioneve për shqyrtimin e lejeve mjedisore, duke pasqyruar në mënyrë të plotë informacionin për dokumentacionin e paraqitur

apo mungesën e tij nga subjektet aplikuese, si dhe të trajtohen në mënyrë të qartë kriteret, problemet apo situatat e veçanta që janë të lidhura vetëm me tematikën e vendimmarrjes për lejet mjedisore.

Gjetje 6: Nga shqyrtimi i dosjeve të aplikimit në DRM Fier, u konstatua se arsyet e refuzimit të lejeve të mjedisit të tipit C nuk shoqërohen me relacion, duke përshkruar, cituar referencën ligjore të saktë dhe të argumentuar, si dhe nuk janë përdorur të njëjta standarde në lidhje me kushtet që duhen të plotësojnë subjektet aplikuese për lejet e mjedisit tipi C. Në shqyrtimin e dosjeve në **30 raste** janë përdorur standarde të dyfishta për plotësimin e kushteve dhe kriterëve.

Rekomandim 6: DRM Fier, të marrë masa që në rastet e refuzimit të lejeve mjedisore, komisionet e shqyrtimit të lejeve të përgatisin akt-refuzimet, të cilat duhet të përmbajnë studimin e plotë të dosjes së aplikimit. Arsyet e refuzimit të shoqërohen me relacione që citojnë referencën ligjore, shkaqet dhe argumentet e refuzimeve, të cilat duhet të kërkojnë respektimin e kushteve apo kriterëve që duhen plotësuar nga subjektet në përmbushje të kërkesave ligjore, së bashku me përcaktimin e llojit të dokumentit standard të kërkuar nga DRM Fier.

Gjetje 7: DRM Fier, për vitin 2015 lidhur me zbatimin e procedurave ligjore në plotësimin e dokumentacionit të Miratimeve për Leje Mjedisit Tipi C dhe argumentimi ligjor të Akt miratimeve nga *153 aplikime të kryera ka miratuar 85 leje mjedisore tipi C ose 55,6 % kundrejt 68 refuzime leje ose 44,4 %, të totalit të aplikimeve, me mangësi në plotësimin e dokumentacionit*. Konstatuam se në **5 raste** në vlerësimin dhe dhënien e licencave jo vetëm që nuk është përdorur i njëjti standard vlerësimi, por janë miratuar me kushtet e paplotësuara kryesisht kushtet që lidhen me dokumente si vërtetime urbanistike, dokumente të titujve të pronësisë apo përdorimit kushte të cilat predominojnë mbi kushtet që përcaktojnë mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet, si ujërat, kimikatet, vajrat e përdorura, mbetjet e ngurta apo të lëngëta etj. *që i përkasin pikave të karburantit të subjektit “S... P... Albania”, përkatësisht:* Akti miratimit LC- 3905 datë 10.7.2015, me aktivitet Pikë Karburanti, Karbunarë Lushnjë, me mos plotësim 2 kushte (vërtetim urbanistik dhe dokument hipotekor i palexueshëm), Akti miratimit LC- 3907 datë 10.7.2015, me aktivitet Pikë Karburanti në lagje 15 Tetor Lushnjë me mos plotësim 1 kusht (vërtetim urbanistik), Akti miratimit LC- 3400, datë 18.6.2015, me aktivitet Pikë Karburanti në Fier, me mos plotësim 3 kushte (planvendosje, certifikata pronësie jo origjinale e pa noterizuar), Akti miratimit LC- 3403, datë 18.6.2015, me aktivitet Pikë Karburanti në Fier me mos plotësim 2 kushte (vërtetim urbanistik certifikata pronësie jo origjinale e pa noterizuar) dhe **subjektin “A.N** Akti miratimit LC- 3209, datë 10.6.2015, me aktivitet Tregtim çimento me mos plotësim 2 kushte (vërtetim urbanistik dhe dokumenti i pronësisë së tokës), veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisit të Tipave A,B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL”.

Rekomandim 7: DRM Fier të marrë masa për rishqyrtimin e **5 rasteve** (praktikave) të Akt Miratimeve të lëshuara në vitin 2015, me mungesë dokumentacioni *që i përkasin pikave të karburantit të subjektit “S...P... Albania”, sa shprehur me sipër , si dhe në mosplotësim të kushteve të anulohet lejet e lëshuara dhe të njoftojë DRISHMP Fier.*

Gjetje 8: DRM Fier, për vitin 2015 në **5 raste leje të Tipit C** ka përcaktuar përfshirë e formuluar kushte (kriterë licencimi) me përcaktime përshkrime të pasakta, formulime të përgjithshme dhe kushte tej kompetencave të DRM (që i përkasin inspektorateve të tjera dhe Higjienës), që sjellin si pasojë vështirësinë e verifikimit (nga DRM dhe nga Inspektorati) si dhe pamundësinë e plotësimit të kushteve të formuluar edhe nga subjekti i licencuar konkretisht:

1. **Për subjektin “P..”**, Akti miratimit LC- 1978, datë 21.4.2015, me aktivitet Furrë Buke, ka përcaktuar 1 kusht të përgjithshëm dhe 2 kushte tej kompetencave;
2. **Për subjektin E.C**, Akti miratimit LC-4741, datë 02.09 2015, aktivitet Furrë buke 1 kusht të përgjithshëm dhe 1 kusht tej kompetencave;
3. **Për subjektin A.S**, Akti miratimit LC- 3111, datë 10.06.2015 (22.05.15), me aktivitet Riparim Makina, 1 kusht të përgjithshëm dhe 1 kusht tej kompetencave (që i përket Inspektoratit të Punës);
4. **Për subjektin D.Z**, Akti miratimit LC- 2430, datë 18.05.2015 me aktivitet Furrë buke, 1 kusht të përgjithshëm dhe 2 kushte tej kompetencave (që i përket Inspektoratit të Punës dhe Inspektoratit të Higjenës);
5. **Për subjektin C.. shpk**, Akti miratimit LC- (3364 ose 3365), datë 18.06.2015 me aktivitet pikë karburanti, 1 kusht tej kompetencave (që i përket Inspektoratit të Punës), në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisit të Tipave A,B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 50-55 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 8: DRM Fier të marrë masa për rishqyrtimin e **5 raste leje të Tipit C** praktikave të Akt Miratimeve të lëshuara viti 2015 me mangësi e përcaktime të pasakta në formulim e në përmbajtje të kushteve të lejeve mjedisore, të saktësojë me NJQV-të, riformulojë përmbajtjen e kushteve, të heqë kushtet e vendosura tej kompetencave të DRM dhe të rishkruajë lejet e sakta, si dhe pasi të anulohet tërheq ato me mangësi të pajisë mbajtësit me lejet e rregullta sikundër trajtuar në faqet e projektraportit përkatësisht:

- subjektin “P...”, Akti miratimit LC- 1978, datë 21.4.2015, me aktivitet Furrë Buke për 3 kushte;
- subjektin E..Ç, Akti miratimit LC- 4741, datë 02.09 2015, aktivitet Furrë buke 2 kushte”;
- subjektin A.s, Akti miratimit LC- 3111, datë 10.06.2015 (22.05.15), me aktivitet Riparim Makina, për 2 kushte;
- subjektin D.Z, Akti miratimit LC- 2430, datë 18.05.2015 me aktivitet Furrë buke me 3 kushte;
- subjektin C.. shpk, Akti miratimit LC- (3364 ose 3365), datë 18.06.2015 me aktivitet pikë karburanti, për 1 kusht.

Gjetje 9: -**Ne 1 rast është dhënë leje të Tipit C në vitin 2015, për subjektin Z.Z** me Akt miratimin LC- 4944, datë 09.09.15 me aktivitet Bar-kafe–restorant Lokal nate me muzikë live, për aktivitet të pjesshëm (vetëm për Muzikë Live) dhe në shkelje të kushtit të distancës për zhurmën (me distancë 5 ml nga 150 ml në fakt), duke lënë, përjashtuar apo mos përfshirë pjesë të aktivitetit (Bar-kafe–restorant), në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisit të Tipave A,B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL”, shtojca 6 dhe me Udhëzimin nr. 5, datë 26.11.2010”Për Kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje mjedisore të thjeshtë të veprimtarive që emetojnë zhurma në mjedis”, referuar këtu edhe shtojcës 1 të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.

Rekomandim 9: DRM Fier të marrë masa për rishqyrtimin e lejes të Tipit C në vitin 2015, **për subjektin Z.Z** Akti miratimit LC- 4944, datë 09.09.15 me aktivitet Bar-kafe-restorant Lokal nate me muzikë live, për aktivitet të pjesshëm (vetëm për Muzikë Live) dhe në shkelje të kushtit të distancës për zhurmën (me distancë 5 ml nga 150 ml në fakt), për shkakun e shprehur se distanca është 150 ml nga banesa më e afërt, kurse sipas aktkontrollit në terren kjo distancë është rreth 5 ml, fakt që tregon kundërshti në deklaratimet e bëra.

Gjetje 10: DRM Fier nuk ka një database (ose nuk u paraqit gjatë procesit auditimit) të numrit të përgjithshëm të subjekteve mbajtës të Lejeve Mjedisore të Tipit C, nuk ka një rakordim me DRTT Fier, me QKL apo dhe me 6 NJQV-të për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në Qarkun Fier dhe nuk ka një listë të audituar të numrit të subjekteve që kanë detyrimin e pajisjes me leje mjedisi për ushtrimin e veprimtarive, të dhëna këto që do ti jepnin mundësinë grupit të auditimit për të shprehur me tregues një opinion të përgjithshëm, lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis për Rajonin (rajon me ndikim të lartë mjedisor), në zbatim të Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar dhe gjithë paketës ligjore për mjedisin .

Rekomandim 10: DRM Fier të marrë masa të krijojnë, vendosin e ndjekin një database, me evidentim të numrit të përgjithshëm të subjekteve mbajtës të Lejeve Mjedisore të Tipit C, të rakordojnë me DRTT Fier, me QKL me 6 NJQV-të për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në Qarkun Fier, të hartojnë një listë të numrit të subjekteve që kanë detyrimin e pajisjes me leje mjedisi për ushtrimin e veprimtarive, të dhëna këto që do të siguronin ndjekjen dhe analizën e problematikës së mbrojtjes së mjedisit, procesin e licencimit të subjekteve për të shprehur me tregues një opinion të përgjithshëm lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis për Rajonin (rajon me ndikim të lartë mjedisor), në zbatim të Ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar dhe të gjithë paketës ligjore për mjedisin si dhe të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar,

Gjetje 11: DRM Fier, për vitin 2014 nuk ka hartuar regjistrin kadastral mjedisor manual, por vetëm atë elektronik për Qarkun nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave konkrete të pasqyruara në lejet mjedisore, e cila i shërben Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për marrjen e masave me qëllim që të evitohet ndotja dhe dëmtimi i mjedisit dhe përbërësve të tij si dhe të rritet cilësia e jetës së qytetarëve për këtë Qark.

Rekomandim 11: DRM Fier, të hartojë regjistrin kadastral mjedisor digjital për Qarkun, nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave konkrete të pasqyruara në lejet mjedisore, e cila i shërben Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për marrjen e masave me qëllim që të evitohet ndotja dhe dëmtimi i mjedisit dhe përbërësve të tij si dhe të rritet cilësia e jetës së qytetarëve për këtë Qark.

Gjetje 12: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të aplikimit që janë shqyrtuar nga DRM Fier për periudhën 2014 konstatohet se, në dokumentacionin e subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C rezultojnë mangësi si: shqyrtimi i lejes nga specialistët e DRM, procesverbalet e komisionit të shqyrtimit, certifikata e pronësisë, dokumenti i dhënies së mendimit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, deklarimi i informacionit në tabelat për shkarkimet; veprime të cilat janë në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja .

Rekomandim 12: DRM Fier të marrë masa për shqyrtimin në mënyrë objektive dhe korrekte të të gjitha kërkesave të subjekteve që kërkojnë të pajisen me Leje Mjedisit Tipi C, të plotësojnë formularin informues sipas kërkesave ligjore që janë në fuqi dhe të plotësojnë dosjen e aplikimit në rrugë elektronike dhe manuale me të gjithë dokumentacionin përkatës dhe mbështetës në lidhje me aktivitetin që do të ushtrojnë.

Gjetje 13: Në vitin 2014 janë lincësuar 29 pika karburanti dhe furnizim për mbushje gazi, nga të cilat për 13 pika karburanti është vendosur Kushti 5 “Shkarkime në Ajër” shoqëruar me tabelën me

normat e shkarkimeve, ndërsa për 16 licencime të tjera ky kusht nuk përfshihet, në kundërshtim me ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 shtojca 2 “për vlerat kufij të shkarkimit të ndotësve” “Lista indikative e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh nëq kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve”, si pjesë e kushteve për dhënien e lejes së mjedisit tipi “C”, e përcaktuar si kërkesë bazuar në VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pika 10, dhe në VKM nr. 435, datë 12.9.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”. Akti i miratimit për lejen e mjedisit të tipit “C” për çdo instalim, përmban sipas rastit, vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve, që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi. Vlerat kufi të shkarkimeve, sipas rastit, mund të zbatohen për grupe ndotësish dhe jo për ndotës të veçantë, pasqyruar në tabelën emërtuar “Licencimi i pikave të karburantit me kushtin 5 – Shkarkimet në ajër, viti 2014”.

Rekomandim 13: DRM Fier, (Drejtori dhe komisionet), të hartojnë hollësisht dhe në mënyrë të detajuar formularët standard për proces-verbalet dhe aktet e miratimit të kërkesave për leje mjedisi tipi “C”, mbi bazën e të dhënave të detajuara për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve, për komponentët mjedisorë “Ajri” dhe “Uji”. DRM të japë një konfirmim negativ, nëq këta komponentë dhe shkarkime ndotësish në ajër dhe ujë, kanë tejkaluar vlerat kufi të shkarkimeve.

Gjetje 14: Nga shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për Leje mjedisore të tipit C nga subjektet “S.. G”, “A.S”, “M.T”, është miratuar e firmosur nga ish Drejtori S.P në gusht - shtator 2014, me kriterin “Industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve” Nga shqyrtimi i aktit të miratimit konstatohet se:

Për serviset e automjeteve që bëjnë ndërrim vajrash, duhet të ishin kërkuar kopjet e kontratës me kompaninë që grumbullon vajrat. Këto kontrata mungojnë, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 me të dhëna për instalimet e kategorisë C, që ndodhen brenda territorit ku shtrihet fusha e kompetencave të tyre.

Rekomandimi 14: Drejtorja Rajonale e Mjedisit, Qarku Fier, (Drejtori dhe komisionet), të hartojë hollësisht dhe në mënyrë të detajuar proces-verbalet dhe aktet e miratimit të kërkesave për leje mjedisi tipi “C”. Për serviset e automjeteve që bëjnë ndërrim vajrash, të vihet kushti për të kërkuar kopjet e kontratës me kompaninë që grumbullon Vajrat.

Gjetje 15: Në të gjitha rastet, për vitin 2014, konstatohet se në DRM Qarku Fier, për shkarkimet e ngurta, nuk është aplikuar norma sipas lejeve mjedisore të lëshuara deri tani, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pika 10 dhe me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”.

Rekomandim 15: DRM Fier të ndryshojë praktikën e deritanishme dhe të marrë masa e të aplikojë norma për shkarkimet e ngurta.

Gjetje 16: Në të 144 dosjet e audituara, për vitin 2014 në DRM Fier, kërkesat (aplikimet) e operatorëve për leje të tipit “C” dhe mendimet për VNM për lejet tipet “A” dhe “B”, vijnë në rrugë elektronike nga QKL-ja. Nuk është nxjerrë ndonjë akt ligjor apo nënligjor për regjistrimin elektronik në rastin e përcjelljes së kërkesave në ARM Qarku Fier dhe përveç kësaj, këto kërkesa (aplikime) vijnë nga QKL (Qendra Kombëtare e Licencimeve) në një kohë që sipas VKM nr. 419, datë 25.06.2014, duhet të përcillen nga AKM (Agjencia Kombëtare e Mjedisit) në ARM Qarku Fier. Kalimi nëpërmjet rrugës elektronike, nuk garanton siguri për të dhënat e përcjella nga QKL, të cilat na u paraqitën në një folder të kopjuar, gjë që nuk jep siguri për saktësinë dhe vlefshmërinë e të dhënave dhe nuk siguron një shprehje të padyshimtë të vullnetit nga ana e përcjellësit të këtyre të dhënave përmes kësaj rruge elektronike.

Kërkesat e aplikuesve (kërkuesve) për leje mjedisore të tipit “C” janë përcjellë nga QKL-ja, nëpërmjet rrugës elektronike (dixhitale) dhe jo në formë shkresore, në kundërshtim me pikën “2”, të

Kreut IV, të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 dhe me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Titulli III.

Rekomandim 16: DRM Fier, të mos pranojë më kërkesa (aplikime) nga operatorë, për leje mjedisore të tipit “C” të cilët vijnë në mënyrë elektronike nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL), por të pranojë vetëm ato kërkesa për leje mjedisore të tipit “C”, të cilat u përcillen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).

Kërkesat e operatorëve për leje mjedisi, të pranohen nga DRM në mënyrën elektronike të bashkëshoqëruar në çdo rast nga dokumentacionet përkatës në trajtën fizike, të nënshkruara e vulosura rregullisht, si dokumentacion që përmban elementet e formës dhe të përmbajtjes për të qenë një akt administrativ i rregullt dhe ligjor.

Gjetje 17: DRM Fier për vitin 2016 ka bërë miratimin e lejeve mjedisore për subjektet që ushtrojnë aktivitet në qarkun e Fierit, jashtë kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.

Rekomandim 17: DRM Fier të marrë të gjitha masat për shqyrtimin në mënyrë objektive dhe korrekte të të gjitha kërkesave të subjekteve që kërkojnë të pajisen me Leje Mjedisi Tipi C, të plotësojnë formularin informues përshkrimin e instalimeve të domosdoshëm për ushtrimin e aktivitetit, të bashkëngjisin planet, skicat, hartat për ta përshkruar të gjithë aspektin e aktivitetit. Të bëjnë deklaratimet në lidhje me mbetjet e ngurta që gjenerohen, gjatë zhvillimit të veprimtarisë, të japin koordinatat GAUS KRUGE, të paraqitet deklarimi i informacionit në tabelat për shkarkimet e ujërave të ndotura, mbetjet e ngurta, përdorimi dhe prodhimi i energjisë, zhurmat dhe vibracionet dhe plotësimi në mënyrë korrekte i kodit kryesor të aktivitetit. Gjithashtu DRM Fier, të kërkojë nga subjektet plotësimin e dosjeve të aplikimit në rrugë elektronike dhe manuale me të gjithë dokumentacionin përkatës dhe mbështetës në lidhje me aktivitetin që do të ushtrojnë dhe lejen përkatëse që pajisen.

Gjetje 18: Në DRM Fier për vitin 2014, nuk evidentohet asnjë raport vetëmonitorimi i paraqitur nga subjektet. Raportimi i subjekteve të pajisura me leje mjedisi A, B dhe C, për vitet 2015 dhe 2016, është bërë jo i plotë dhe josistematik sipas periudhave përkatëse të raportimit të vetë monitorimeve, por në mënyrë sporadike, duke mos respektuar kriterin e dorëzimit të numrit të detyruar të raporteve të vetëmonitorimit për çdo vit. Nga 54 subjekte të paisura me leje të tipit A dhe B të cilët kanë patur detyrimin të dorëzonin AKM 305 raporte vetëmonitorimi kanë dorëzuar 133 raporte ose 44 % të planifikimit. Nga 165 subjekte të paisura me leje mjedisi tipi C të cilat në kushtet e lejes kanë patur detyrimin të dorëzonin pranë DRM Fier, 490 raporte vetëmonitorimi kanë dorëzuar 198 raporte ose 40% të planifikimit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kushtet e vendosura në lejen e mjedisit, me Ligjin nr. 10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit”, dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.

Rekomandim 18: DRM Fier dhe AKM Tiranë të bashkëpunojnë me ISHMP Tiranë, të marrin masat për të njoftuar DRISHMP Fier për 54 subjekte të pajisura me leje të tipit A dhe B, të cilët kanë patur detyrimin të dorëzonin AKM 305 raporte vetëmonitorimi. Ndërkohë që kanë dorëzuar 133 raporte ose 44 % të planifikimit; si dhe për 165 subjekte të paisura me leje mjedisi tipi C të cilat në kushtet e lejes kanë patur detyrimin të dorëzonin pranë DRM Fier, ku nga 490 raporte vetëmonitorimi që duheshin, kanë dorëzuar 198 raporte ose 40% të planifikimit, të paplotësuara për

vitin 2014, 2015 dhe 2016, si detyrime të paplotësuara në lidhje me vetëmonitorimet e përcaktuara në kushtet e Lejes Mjedisore. Të rrisin bashkëpunimin institucional për koordinimin dhe për realizimin e detyrave për të cilët këto institucione janë përgjegjës, sipas tabelës emërtuar “Subjektet që kanë kryer monitorime të pjesshme dhe nuk kanë plotësuar numrin e monitorimeve periodike për çdo vit, 2015 dhe 2016 në kundërshtim me nenin 29 pika b (iii) i Ligjit nr. 10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit””.

Gjetje 19: Gropat ekologjike të krijuara nga shoqëria “B... P...” dhe gropat mbledhëse të naftës që krijohen nga shoqëria A..... sh.a, në të cilat janë depozituar mbetjet e dala nga procesi i shpimit dhe i prodhimit të naftës bruto, të cilat përbëjnë mbetje të rrezikshme, krijojnë për zonën një ndotje të madhe të tokës dhe ajrit, pasi nuk ka një impiant për trajtimin sa më të shpejtë të naftës së mbledhur në këto gropa të hapura, në kundërshtim me Ligjin 10 431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar dhe Ligjin 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”. Nga ana e shoqërive të nxjerrjes dhe përpunimit të naftës me aktivitet në Qarkun Fier, nuk janë marra masa parandaluese për kufizimin dhe ndalimin e derdhjes së mbetjeve të naftës në zonën bregdetare nga ana e shoqërive si, A..., “B... P...” dhe A.... Ka disa zona të burimeve të naftës, ku nuk është përcaktuar qartë se cila zonë i përket shoqërisë A... sh.a dhe cilat janë zonat e shoqërive të tjera.

Rekomandim 19: AKM dhe DRM Fier në bashkëpunim me DRISHMP Fier, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndikimet negative tokës, ajrit dhe të ujërave të ndotura nga shoqëritë që merren me nxjerrjen dhe përpunimin e naftës etj., të evidentojë saktë zonat e veprimtarisë të subjekteve, të cilat shkaktojnë ndotje të tokës, ajrit dhe ujërave mbi normat e lejuara, duke ushtruar kontrole të këtyre subjekteve dhe territorit në të cilin ato ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe kërkuar krijimin e gropave septike, për trajtimin e ujërave teknologjike dhe rehabilitimin e mjedisit. Gjithashtu, AKM dhe DRM Fier në bashkëpunim me DRISHMP Fier të marrë masa për subjektet që krijojnë ndotje deri në pezullimin ose revokimin e lejes së tyre, në zbatim të Ligjit 10 431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar dhe Ligjit 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”.

Gjetje 20: Problem madhor është edhe teknologjia e përdorur nga shoqëria kanadeze “B... P...” për shpimin e puseve të naftës, disa prej të cilëve kanë shpërthyer në datën 01.04.2015, duke vënë në rrezik banorët që jetojnë shumë pranë zonës ku nxirret nafta. Shpërthimi i ujërave nëntokësore në oborret e banesave dhe çlirimi i gazrave, detyroi autoritetet të evakujnë banorët nga rreziku i ndotjes së mjedisit.

Për sa më lartë, me gjithë faktet e përsëritura në Raportet e Ndikimit në Mjedis për vitet 2014 dhe 2015 (2016 në proces), fakte që lidhen me dëmtimet në mjedis nga “B...P...”, nga DRM Fier nuk ka informacion në lidhje me ndërmarrjen e hapave nga ana e AKM dhe DRM Fier për të bashkëpunuar me inspektoratet e ndryshme apo institucionet e tjera. Mosveprime këto të cilat kanë sjellë si pasojë mosvendosjen e sanksioneve përkatëse, për ndjekjen dhe shkeljen e kushteve të lejes mjedisore ndaj B...P....., por mbi të gjitha mosvlerësimin e dëmeve të shkaktuara në Zharrëz dhe ndotje masive në mjedis.

Pavarësisht faktit që B... P... ka leje mjedisore të tipit A, kjo nuk përjashton DRM Fier, për të informuar dhe bashkëpunuar me AKM dhe DISHMP Fier, me qëllim mbrojtjen e mjedisit në juridiksion territorial ku ajo ushtron kompetencat e veta. Veprime këto, që bien në kundërshtim me Ligjin 10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe Ligjin nr. 10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” .

Rekomandim 20: AKM Tiranë dhe DRM Fier të marrin masa të menjëhershme bashkëpunuese me DRISHMP Fier dhe strukturat e tjera për llogaritjen e dëmit dhe vendosjen e sanksioneve të pallogaritura dhe të pavendosura ndaj shoqërisë “B...P...”, si dhe të rishqyrtoj, analizoj dhe vendos për kushtet e lejes mjedisore lëshuar kësaj shoqërie.

Gjetje 21: DRM nuk ka vepruar për njoftimin e DRISHMP Fier me listën e 92 subjekteve që nuk kanë plotësuar detyrimin për plotësimin e kushteve të lejes së mjedisit për vitet 2014 dhe 2015 në lidhje me deklarimin e sasisë së vajrave të prodhuar, grumbulluar, ricikluar dhe dorëzuar në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe ligjin 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” .

Rekomandim 21: DRM Fier, të marrë masa për të njoftuar DRISHMP Fier për zbatimin e kompetencave ligjore në lidhje me 92 subjektet të cilat nuk kanë plotësuar detyrimin për plotësimin e kushteve të lejes së mjedisit në lidhje me deklarimin e sasisë, llojin dhe origjinën e vajrave të prodhuar, grumbulluar, përdorur, ricikluar dhe dorëzuar, për vendosjen e sanksioneve të pavendosura për vitet 2014,2015 dhe 2016 nga mosplotësimi i këtij kushti, si dhe të marrë në rishqyrtim lejet e dhëna , për mosplotësim të kushteve, të bëjë anulimin e tyre, duke njoftuar QKL.

Gjetje 22: DRM Fier nuk ka mbajtur Librin i Regjistrimit të vajrave të përdorur për deklarimin e destinacionit përfundimtar të mbetjeve si detyrim ligjor për subjektet që me veprimtarinë e tyre gjenerojnë mbetje të rrezikshme vajore si uzina, fabrika, pika shërbimi, ofiçina, servise makinash që merren me ndërrimin e vajrave, porte, aeroporte, hidrocentrale, hekurudha, firma transportesh, kompani të përpunimit të naftës etj., në kundërshtim me Urdhër Nr. 1212 të Ministrit të Mjedisit, datë 13.11.2013 “Për miratimin e modelit të regjistrave të subjekteve që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vajra të përdorur” dhe VKM nr. 765, datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura” .

Rekomandim 22: DRM Fier të marrë masa, për dokumentimin e saktë në Librin e Regjistrimit dhe krijimin e një database me të dhënat e subjekteve që prodhojnë, importojnë, grumbullojnë, riciklojnë, asgjësojnë apo shesin në tregun vendas vajra lubrifikantë apo industriale dhe gjenerojnë mbetje vajore të rrezikshme, si dhe të sasisë, cilësisë, origjinës dhe vendodhjes të vajrave, daljen apo marrjen në dorëzim të tyre me datat përkatëse, me synim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga pasojat e dëmshme të shkaktuara nga shkarkimet, depozitimi apo trajtimi i vajrave të përdorur.

Gjetje 23: Në asnjë rast për periudhën objekt auditimi, nuk është informuar me shkresa përcjellëse QKL-ja sipas ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, neni 25, Tarifat për lejet e mjedisit të tipit C. pika 6. Agjencia përkatëse Rajonale e Mjedisit i kërkon QKL-së revokimin e lejes së mjedisit të tipit C, për revokimin e lejeve të këtyre subjekteve të cilat nuk kanë kryer tarifën vjetore, si dhe kanë kaluar të gjitha afatet për kryerjen e pagesave .

Rekomandim 23: DRM Fier të marrë masat që të informojë me anë të shkresave përcjellëse në çdo rast QKL-në, në mënyrë që të merren masat për revokim të lejeve për subjekteve që nuk kanë paguar tarifën vjetore në kundërshtim me ligjin e sipërcituar.

Gjetje 24: Për pëlqimet e vjetra mjedisore DRM Fier, për periudhën 2009-2014, në bazë të ligjit 10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” nuk ka asnjë të dhënë nëse këto subjekte vazhdojnë aktivitetin e tyre apo e kanë mbyllur si aktivitet, si dhe nuk kanë një database të mbajtur nëse këto subjekte kanë aplikuar për leje mjedisore të tipit A,B dhe tipit C, apo nëse janë pjesë e subjekteve të cilat rezultojnë si debitorë për periudhën 2014-2015.

Rekomandim 24: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier, të marrë masat që të evidentohet të gjitha subjekte që kanë qenë të pajisura me pëlqime mjedisore, për periudhën 2009-2014, të evidentohen dhe të merren masa për tu pajisur me leje mjedisore, sipas ligjeve të sipërcituara.

Gjetje 25: DRM Fier në fund të vitit 2016 u konstatua se ka mosplotësim të strukturës me 2 (dy) punonjës (specialist Finance dhe specialist VNM-je), në kundërshtim me Urdhrin nr.150 datë

17.04.2014, 'Për një ndryshim në urdhrin nr.55, datë 13.02.2014 të Kryeministrit 'Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës Agjencisë Kombëtare të Mjedisit .

Rekomandim 25: DRM Qarkut Fier duhet të kërkoj dhe plotësoj një strukturë organike funksionale në përmbushje të detyrave ligjore të kryerjes së veprimeve pasi kjo mungesë ka sjell probleme në organizimin ekonomik financiar të kësaj DRM-je.

Gjetje 26: Për vitin 2015 DRM Fier nuk ka kryer inventarin fizik të pasurisë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.2.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, Kapitulli IV "Sistemi Kontrollit Periodik të Aktiveve", pika 74 si dhe nuk është mbajtur kontabilitet sipas SKK.

Rekomandim 26: DRM Fier duhet të kryej inventarizimin e pasurisë dhe vlerën e aktiveve në administrim të institucionit, në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.2.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, si dhe të bëjë inventarizimin e plotë të pasurisë së saj dhe të bëhet kontabilizimi i veprimeve sipas SKK.

Gjetje 27: Drejtoria Rajonale Fier, nuk ka ngritur që në fillim të vitit kalendarik komisioni i blerjeve me vlera të vogla, nuk ka kryer llogaritje të fondit limit, mungojnë specialistë me kompetencë profesionale në këtë fushë, etj., veprime që bien në kundërshtim me udhëzimin nr. 3 datë 27.05.2015 "Për blerjet me vlera të vogla".

Rekomandim 27: DRM Fier të marrë masa dhe të ngrejë komisionin e blerjeve me vlera të vogla që në fillim të vitit kalendarik, të përcaktohen kërkesat e nevojat sipas procedurës ligjore dhe të kërkohej nga Titullari i AK dokumentimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi.

Gjetje 28: Komisionet e vlerësimit të "blerjeve me vlera të vogla", nuk ka bërë inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të dosjeve të, procedurave zbatuar për blerjet me vlera të vogla mosveprime të cilat bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 03.04.2014 "*Për një shtesë në udhëzimin nr. 4, datë 04.07.2013, të Agjencisë së Prokurimit Publik, "Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë"* ku thuhet shprehimisht që "autoriteti kontraktor duhet të bëjë arkivimin e procedurës së prokurimit brenda 1ditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit fitues .

Rekomandim 28: DRM Fier të marrë masa e kërkojë nga komisioni i vlerësimit të ofertave për çdo rast për blerjet me "vlerë të vogël", të kryejë inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të praktikave sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3 datë 03.04.2014 "*Për një shtesë në udhëzimin nr. 4, datë 04.07.2013. "Për blerjet me vlerë të vogël"* .

Gjetje 29: Nuk ka një program pune për vitet 2014, 2015 dhe 2016 lidhur me bashkëpunimin dhe kontrollin e përbashkëta si dhe nuk ka marrëveshje ndërmjet AKM, DRM Fier me organet e tjera të kontrollit, si me DRISHMP (Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve) Fier, DRISHU (Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Ujërave), me NjQV-të përkatësisht 6 bashkitë, me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve për gjendjen mjedisore, marrëveshje këto që nga bashkëpunimi i institucioneve të mësipërme, do të shërbenin mbrojtjes së mjedisit në përmbushje të kërkesave të Ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

Rekomandim 29: DRM Fier të marrë masa për lidhjen e marrëveshjeve me organet e tjera të kontrollit, lidhur me bashkëpunimin për kryerjen e inspektimit dhe kontrolleve të përbashkëta, duke hartuar plane pune, programe kontrolli ndërmjet AKM Tiranë dhe DRM Fier me organet e tjera të kontrollit, si me DRISHMP (Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve) Fier, DRISHU (Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Ujërave), me NjQV-të përkatësisht 6 bashkitë, me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve për gjendjen mjedisore, në përputhje me Ligjin nr.

10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu II “Parimet e mbrojtjes së Mjedisit”, neni 11 “Parimi i përgjegjësishë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit”, pika 1.

C. PËR DERDHJEN NË BUXHET TË TË ARDHURAVE TË MUNGUARA

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin e vlerës totale **70,300,000 lekë, të konsideruar si e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit, si më poshtë:**

Gjetje 1: Nuk ka asnjë njoftim nga DRM Fier drejtuar DRISHMP me listën e subjekteve që kanë detyrimin për raportim të vetëmonitorimeve të detyruara dhe numrin faktik të vetëmonitorimeve të dorëzuar, apo numrin e vetëmonitorimeve të paraportuar për periudhat përkatëse, në kundërshtim me Ligjin nr.10431 “Për mbrojtjen e mjedisit”, dhe kushteve të lejes së mjedisit të përcaktuara në formularin tip të kërkesës për leje mjedisore të Tipit C, Ligjin nr.10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit”, dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja” dhe VKM nr.1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin kombëtar të monitorimit të mjedisit”. Mungesa e raporteve të vetëmonitorimit është konstatuar për 165 subjektet e pajisura me leje tipi C me raportime të pjesshme, për 46 subjektet e pajisura me leje mjedisi të tipit B me raportime të pjesshme dhe për 7 subjektet e pajisura me leje mjedisi të tipit A me raportime të pjesshme, të cilat nuk kanë plotësuar kriterin, pra numrin e vetëmonitorimeve brenda vitit, në zbatim të nenit 29 pika b (iii) i Ligjit nr. 10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit”. Për mosplotësimin e kushteve të lejes përse i përket plotësimin të numrit të vetëmonitorimit do të duhej të aplikoheshin gjoba nga 300,000 lekë deri në 1,000,000 lekë, ***vlerë që konsiderohet si e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit dhe që në periudhën e auditimit kap vlerën totale prej 70,300,000 lekë***.

Nga auditimi u konstatua se me shkresën nr.659 datë 12.10.2015, Drejtor i DRM Fier ka dërguar në DRISHMP Fier, listën e subjekteve të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e vetëmonitorimit, listë me 30 subjekte për vitin 2015, të cilat nuk kanë paraqitur raportet e vetëmonitorimit por ndërkohë këto subjekte nuk janë ndëshkuar sipas nenit 29 pika b (iii) i Ligjit nr.10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit”, me gjobë në vlerën nga 300 mijë lekë deri në 500 mijë lekë. Me shkresën nr.668 datë 15.10.2015, Drejtor i DRM Fier ka dërguar shkresë ISHMP Fier, listën e subjekteve të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e vetëmonitorimit për 15 subjekte për vitet 2014-2015, ndërkohë që nuk janë vendosur penaltete bazuar në kërkesat e nenit 29 pika b (iii) i Ligjit nr.10488, datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit”.

Bazuar në raportimet e vëna në dispozicion, janë 269 subjekte të cilat nuk kanë paraqitur raportet e vetë monitorimit dhe për të cilat mungesa e penaltetit ka sjellë një mungesë të ardhurash nga **80,700 mijë lekë (nëse do të aplikoheshin niveli minimal i penaltetit) e deri në 134,500 mijë lekë (nëse do vendosej penaltetit maksimal)**. Kjo vlerë përbën dëm ekonomik.

Rekomandim 1: DRM Fier, të marrë masat për të njoftuar DRISHMP Fier për subjektet që nuk kanë dorëzuar raportet periodike të vetëmonitorimit për vitin 2015 dhe 2016, me qëllim marrjen e masave të menjëhershme në përputhje me kërkesat dhe detyrat e përcaktuara nga kuadri rregullator si dhe për vendosjen e sanksioneve përkatëse, të pa vendosura, për mosplotësimin e kushteve të lejes përse i përket raportimeve periodike të vetëmonitorimit, sipas ***tabelës emërtuar “Subjektet që kanë kryer monitorime të pjesshme dhe nuk kanë plotësuar numrin e monitorimeve periodike për***

çdo vit, 2015 dhe 2016 në kundërshtim me nenin 29 pika b (iii) i Ligjit nr. 10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit”.

Të analizohet situata edhe për raportimet periodike që duhet të realizoheshin edhe për vitin 2014 duke shoqëruar shkeljet e konstatuara edhe me sanksionet respektive, në mënyrë që mbrojtja e mjedisit të mos jetë një proces formal dhe që realizohet me fushata.

C.2 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjetje 1: Në auditimin e kryer në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Fier u konstatua për periudhën e audituar, janë të pajisura me leje mjedisore të **tipit C 433**, subjekte nga të cilat nuk kanë paguar detyrimin e tarifave në kundërshtim me ligjin nr.10488 datë 27.04.2011 “Për Lejet Mjedisore”, me një vlerë prej **866,000 lekë** si e ardhur e munguar ne buxhetin e shtetit.

Rekomandim 1: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Fier, të marrë të gjitha masat që subjektet që janë debitorë të bëjnë arkëtimin e shumës në vlerën **prej 866,000 lekë**.

D. MASA DISIPLINORE

D/1. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, në ligjin nr.10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, në ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM nr.47, datë 29.01.2014 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit”, **i rekomandoj Ministrin të Mjedisit dhe Drejtorin të Përgjithshëm të AKM Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës me status nëpunësi civil fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga “**Vërejtje**” deri “**Largim nga shërbimi civil**” për:

1. Për z. E. Z, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM), për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në *Procesverbali nr.7, datë 07.02.2017, procesverbalin nr.10, datë 9.02.2017, Procesverbali nr.12, datë 10.02.2017, dhe procesverbalin nr. 13. datë 10.02.2017,*

2. Për z. Dh.B, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në *Procesverbali nr.7, datë 07.02.2017, procesverbalin nr.10, datë 9.02.2017, Procesverbali nr.12, datë 10.02.2017, dhe procesverbalin nr. 13. datë 10.02.2017,*

3. Për z. E.B, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në *Procesverbali nr.7, datë 07.02.2017, procesverbalin nr.10, datë 9.02.2017, Procesverbali nr.12, datë 10.02.2017, dhe procesverbalin nr.13, datë 10.02.2017,*

4. Për znj. A.K, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM) për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në *Procesverbali nr.7, datë 07.02.2017, procesverbalin nr.10, datë 9.02.2017, Procesverbali nr.12, datë 10.02.2017, dhe procesverbalin nr. 13. datë 10.02.2017,*

5. **Për znj.E.B**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM), për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në *Procesverbali nr.7, datë 07.02.2017,procesverbalin nr.10, datë 9.02.2017, Procesverbali nr.12, datë 10.02.2017, dhe procesverbalin nr.13. datë 10.02.2017,*

6. **Për z. B.F**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM), për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në *Procesverbali nr.7, datë 07.02.2017,procesverbalin nr.10, datë 9.02.2017, Procesverbali nr.12, datë 10.02.2017, dhe procesverbalin nr.13. datë 10.02.2017,*

7. **Për zj. V.G**, me detyrë specialiste e monitorimit për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në *procesverbalin nr. 6, datë 06.02.2017, në Procesverbal nr.8, datë 08.02.2017.*

Për z. E.B, me detyrë specialist dhe me cilësinë Drejtor i Komanduar me shkresë nr.1780, datë 23.09.2015 e vazhdim, të vlerësohet niveli i masës nga Titullari i AKM dhe Ministrit të Minisrisë së Mjedisit, bazuar në nivelin e shkeljeve të referuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikes.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R